



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 483/4 Prot.

Tiranë, më 15.05.2026

NJOFTIM

“MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT NGA KOMISIONI I VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE TË KRYERA NGA OJF-TË PËR PËRFITIMIN E FINANCIMEVE NGA BUXHETI I SHTETIT PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”, Ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimit Nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, ndryshuar me VKM nr. 227, datë 23.04.2023, Kreut VI të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” miratuar me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë, Urdhrit nr. 104, datë 19.02.2026, të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuar”, Metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhër nr. 124 datë 10.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, **Komisioni i vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar:**

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Albanian Legal and Territorial Research Institute*” (ALTRI) me vendimin nr.11, datë 14.05.2026;
2. Pranimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Të Ndryshëm Dhe Të Barabartë*” me vendimin nr. 10, datë 14.05.2026;
3. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat (MDG-Berat)*”, me vendimin nr.6, datë 14.05.2026;
4. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)*”, me vendimin nr.7, datë 14.05.2026;

5. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Qendra Psiko-Sociale Vatra*”, me vendimin nr.8, datë 14.05.2026;
6. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Qendra Shqiptare për Impakt Social*” me vendimin nr.9, datë 14.05.2026;
7. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Instituti i Migracionit për Zhvillimi dhe Integritimit (IMZHI)*” me vendimin nr.12 datë 14.05.2026;
8. Refuzimin e kërkesës për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti të organizatës jofitimprurëse “*Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)*” me vendimin nr. 05 datë 14.05.2026.

Pika 16, e VKM-së nr. 110/2019 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre*”, të ndryshuar, parashikon se:

16. Vendimi i komisionit vlerësues mund të ankimohet pranë komisionit të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i rezultateve për shkëlje të procedurave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË

**(DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)**

Patricia Pogaçe

Patricia
Pogaçe

Digitally signed by
Patricia Pogace
Date: 2026.05.15
11:37:01 +02'00'

